

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar
Financial Accounting

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 26.09.2020

Problemi 1

Turbeog shpk ("TURBEOG") është një kompani prodhuese që operon në industrinë ushqimore. Më 1 korrik 2019, TURBEOG bleu një aksione të aksioneve në Veranda shpk. Pasqyrat e pozicionit financiar të TURBEOG dhe VERANDA më 31 dhjetor 2019 janë dhënë më poshtë.

	TURBEOG 31 dhjetor 2019		VERANDA 31 dhjetor 2019	
	€ 000	€' 000	€' 000	€' 000
PASURITE				
Pasuritë jo qarkulluese				
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit, Pajisjet		21,400		5,000
Investimet në VERANDA		<u>5,000</u>		<u>zero</u>
Totali i pasurive jo qarkulluese		26,400		5,000
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet	2,000		1,000	
LL/A	600		1,200	
Paraja e gatshme	<u>1,800</u>		<u>800</u>	
Totali i pasurive qarkulluese		4,400		3,000
Totali i pasurive		30,800		8,000
EKUITETI DHE DETYRIMET				
Ekuiteti				
Kapitali aksionar (€1 secila)	4,000		1,000	
Premia në aksione	2,000		1,000	
Fitimet e mbajtura	21,800		5,000	
Totali i ekuitetit		27,800		7,000
Detyrimet afatshkurta				
LL/P	<u>3,000</u>		<u>1,000</u>	
Totali i detyrimeve afatshkurta		3,000		1,000
Total ekuitetit dhe detyrimeve		30,800		8,000

Duhet të merren parasysh informacionet e mëposhtme:

- TURBEOG ka paguar € 5,000,000 në para të gatshme më 1 korrik 2019 për 80% të aksioneve të VERANDA shpk.
- Në datën e blerjes, vlera e drejtë e pasurive të Veranda ishte e barabartë me vlerën e tyre në libra, me përjashtim të tokës. Toka kishte një vlerë të drejtë prej € 300,000 nën vlerën e saj në libra. Vlera e drejtë e tokës nuk është pasqyruar në pasqyrat financiare të Veranda.
- Veranda ka realizuar fitimin prej € 2,400,000 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019. Fitimi është realizuar njëtrajtësisht gjatë vitit (supozohet të jetë i njëjtë për secilin muaj);
- Gjatë periudhës pas blerjes, Veranda shiti mallra për TURBEOG në shumë prej € 500,000. Veranda shet mallra me një marzhë prej 20% e shitjeve. Në 31 dhjetor 2019, 30% e këtyre mallrave ishin të pashitura nga TURBEOG;
- Më 31 dhjetor 2019, Veranda kishte Llogari të arkëtueshme ndaj Turbeog në shumë prej €200,000, të cilat ishin përfshirë në Llogaritë e pagueshme të Turbeog.
- Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në blerje ishte 1,100,000 €.

Kërkohet:

- a) Kalkuloni zërin e mirë në blerje më 1 korrik 2019 (5 pikë)
- b) Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019.

(15 pikë)

Totali (20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

a)

Zëri i mirë	€' 000	€' 000
Konsiderata e transferuar	5,000	
Vlera e drejtë e IJK-së në blerje	1,100	6,100
<u>Vlera e drejtë në blerje e neto pasurive</u>		
Kapitali aksionar	1,000	
Premia në aksione	1,000	
Fitimet e mbajtura në blerje	Shënimi 1 00	
Korrigjimet e vlerës së drejtë-Toka	(300)	(5,500)
Zëri i mirë në blerje		<u>600</u>

Shënimi 1: Kalkulimi i fitimeve të mbajtura në blerje

Fitimet e mbajtura më 31.12.19	5,000
Minus fitimi për 6 muaj ($2,400 * 6/12$)	(1,200)
Fitimet e mbajtura në blerje më 1.7.19	<u>3,800</u>

b)

Fitimet e mbajtura

	TURBEOG €' 000	VERANDA €' 000
Sipas pyetjes	21,800	5,000
Fitimet e mbajtura në blerje		(3,800)
Korrigjimet e fitimit të perealizuar	Shënimi 1 Shënimi 2	(30)
		<u>1,170</u>
<u>Pjesa që i takon grupit ($80\% * 1,170$)</u>	<u>936</u>	
Fitimet e mbajtura të grupit	22,736	

Shënimi 2: Fitimi i perealizuar

Shitjet (100%)	500
KMSH (80%)	<u>(400)</u>
Fitimi bruto (20%)	100
Fitimi i perealizuar = $30\% * 100$	30

Shënimi 3

IJK në datën e raportimit `000

Vlera e drejtë e IJK-së në blerje 1,100

Plus Pjesa e IJK-së e fitimeve të mbajtura pas blerjes (20%*1,170) 234

IJK në datën e raportimit 1,334

Turbeog shpk Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

Pasuritë jo qarkulluese	€' 000	€' 000
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit, Pajisjet (21,400 + 5,000 - 300)		26,100
Zëri i mirë	(a)	600
Totali i pasurive jo qarkulluese		26,700
 Pasuritë qarkulluese		
Stoqet (2000 + 1000 - 30 fitimi i parealizuar)	2,970	
LL/ A (600 + 1,200 - 200)	1,600	
Paraja e gatshme (1,800 + 800)	2,600	
Totali i pasurive qarkulluese		7,170
Totali i pasurive		33,870
 Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Kapitali aksionar	4,000	
Premia në aksione	2,000	
Fitimet e mbajtura	22,736	
		28,736
Interesi jo-kontrollues (Shënimi 3)		1,334
 Totali i ekuitetit		30,070
Detyrimet afatgjata		0
 Detyrimet afatshkurta		
LL/P (3,000 + 1,000 - 200)		3,800
Totali i detyrimeve		3,800
 Totali i Ekuitetit dhe Detyrimeve		33,870

Problemi 2

Ju jeni të punësuar nga Hana shpk si një kontabilist praktikant. Ju aktualisht jeni duke finalizuar llogarinë kontrolluese të arkëtueshmeve tregtare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019. Ju është dhënë informacioni i mëposhtëm:

1. Saldo e llogarisë kontrolluese të të arkëtueshmeve tregtare më 1 janar 2019 ishte € 216,420;
2. Hana bën të gjitha shitjet me kredi. Transaksionet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 përfshijnë sa vijon:

Detajet	€
Shitjet për klientët	824,380
Kthimet e shitjeve nga klientët	10,300
Zbritjet e lejuara	9,260
Borxhet e këqija të fshira	4,600
Paraja e gatshme e arkëtuar nga klientët	790,320

Kërkohet:

- a) Përgatitni të gjitha regjistrimet në ditar për transaksionet e mësipërme; (5 pikë)
- b) Përgatitni Llogarinë kontrolluese të të arkëtueshmeve për Hana për vitin që përfundon më 31.12.2019 (5 pikë)

Totali 10 pikë

Zgjidhja e problemit 2

a)

D.	LL/ A	€	€
K	Të hyrat nga shitja	824,380	824,380
Dr	Kthimet e shitjeve	10,300	
K	LI/ A		10,300
D	Zbrijet e lejuara	9,260	
K	LI/ A		9,260
D	Shpenzimet e borxheve të këqija	4,600	
K	LI/ A		4,600
D	Paraja e gatshme	790,320	
K	LI/ A		790,320

b)

Llogaria kontrolluese e LL/A

Saldo në fillim	216,420	Kthimet e shitjeve	10,300
Të hyrat nga shitja	824,380	Zbritjet e lejuara	9,260
		Borxhet e këqija	4,600
		Paraja e gatshme	790,320
		Saldo balancuese	226,320
	<u>1,040,800</u>		<u>1,040,800</u>
Saldo në fund	226,320		

Problemi 3

Jehona shpk po finalizon pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018. Saldo sipas librit të arkës është € 21,834 në atë datë. Megjithatë, saldo sipas ekstraktit bankar të të njejtës datë është € 22,474. Kanë dal në pah diferencat e mëposhtme:

- Nga rishikimi i ekstraktit bankar, janë identifikuar zërat e mëposhtëm, të cilët nuk janë regjistruar në librin e arkës të Jehona shpk:

	€
Pagesa ndaj furnitorit	1,260
Shpenzimet bankare	101
Debitimi direkt për sigurime	820

-
- Çeku me numër 3451, me shumë prej €1,623, ishte lëshuar nga Jehona më 23 dhjetor 2018. Ky çek ishte paraqitur në bankë për pagesë më 4 janar 2019.
- Ishin bërë depozitime në shumë prej €742 nga Jehona më 31 dhjetor 2018. Kjo nuk është paraqitur në ekstraktin bankar deri më 2 janar 2019.
- Një pagesë prej € 2,120 e arkëtuar nga Jehona nga një klient, ishte regjistruar dy herë gabimisht në bankë;
- Më 16 dhjetor 2018, Jehona ka thyer në bankë një çek të marr nga një klient në shumë prej €1,680. Megjithatë, kontabilisti i Jehona shpk gabimisht e ka regjistruar në librat e kompanisë si € 1,860.

Kërkohet:

Përgatitni harmonzimin bankar dhe krahasimin me librin e arkës për muajin Dhjetor 2018 për Jehona shpk.

20 pikë

Zgjidhja e problemit 3

Libri i arkës

Dhjetor

31 Saldo 21,834

Dhjetor

31 LL/P 1,260

31 Shpenzimet bankare 101

31 Sigurimi 820

31 Dallimi në gabim 180

31 Saldo në fund

e korrigjuar

19,473

21,834

21,834

Harmonizimi bankar

Saldo e pakorrigjuar - 31/12/2018 22,474

Minus: Çeçet e paparaqitura (1,623)

Plus: Depozitat në tranzit 742

Gabimi i bankës: Depozitat e paraqitura dyfish (2,120)

Saldo e korrigjuar e bankës 19,473

Problemi 4

Drini sh.p.k është një kompani e cila prodhon dhe shet mobilje. Në vijim janë paraqitur Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2016 dhe 2017 dhe Pasqyra e të Ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

Drini sh.p.k
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016 dhe 2017

	2017	2016
	€' 000	€' 000
Pasuritë		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Patundshmëritë, impijantet e prodhimit dhe pajisjet	2,289	1,849
Totali i pasurive jo qarkulluese	2,289	1,849
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	242	210
LL/A	248	226
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40	36
Totali i pasurive qarkulluese	530	472
Totali i pasurive	2,819	2,321
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme (€ 2 secila)	140	100
Rezerva e rivlerësimit	56	10
Fitimet e mbajtura	1,440	1,110
Totali i ekuitetit	1,636	1,220
Detyrimet afatgjata		
Kredia afatgjatë	500	400
Totali i detyrimeve afatgjata	500	400
Detyrimet afatshkurtra		
LL/P	641	675
Tatimi i pagueshëm	42	26
Totali i detyrimeve afatshkurtra	683	701
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	2,819	2,321

Drini sh.p.k
Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017

	€' 000
Të hyrat nga shitja	1,440
KMSH	(625)
	815
Shpenzimet administrative	(214)
Shpenzimet e interesit	(32)
Shpenzimet e shpërndarjes	(107)
Fitimi para tatimit	462
Shpenzimet e tatimit	(56)
Fitimi neto	406

Informata shtesë:

- a) Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2017 janë € 326,000.
- b) Drini ka realizuar humbje prej € 40,000 në shitjen e një pasurie jo qarkulluese. Vlera neto në libra e kësaj pasurie në datën e shitjes ishte €220,000.
- c) Drini ka paguar dividendë në shumë prej € 76,000 në Nëntor 2017.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e rrjedhave të arkës me metodën direkte për kompaninë Drini shpk për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017, në përputhje me kërkesat e *SNK 7 Pasqyra e Rrjedhave të Arkës*;

Totali 20 pikë

Aktivitetet operative	€ '000	
Fitimi para tatimit	462	
<u>Korrigjimet për:</u>		
Zhvlerësimin	326	
Humbjen kapitale	40	
Shpenzimet e interesit	32	
	860	
Rritja në LL/A	(22)	
Rritja në stoqe	(32)	
Rënia në LL/P	(34)	
	772	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet		
Interesi i paguar	(32)	
Tatimi i paguar	(40)	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet operative		700
Aktivitetet investuese		
Blerja e PIP (Shënimi 2)	(940)	
Shitja e PIP	180	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet investuese		(760)
Aktivitetet financuese		
Emetimi i aksioneve	40	
Rritja e kredive afatgjata	100	
Dividenda e paguar	(76)	
Rrjedha neto e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese		64
Rrjesha neto e parasë gjatë vitit		4
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fillim		36
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët në fund		40
<u>Shënimi 1: Tatimi i pagueshëm</u>	€'000	
Saldo në fillim 1.1.2017	26	
Shpenzimet e tatimit	56	
	82	
Paraja e gatshme e paguar (shifër balancuese)	(40)	
Saldo në fund 31.12.2017	42	

Shënimi 2: PIP

Saldo në fillim 1.1.2017

Zhvlerësimi

Shitja

Rezerva e rivlerësimit

Blerjet e PIP (Shifër balancuese)

Saldo në fund 31.12.2017

€'000

1,849

(326)

(220)

46

1,349

(940)

2,289

Problemi 5

Bilanci vërtetues i mëposhtëm është nxjerrë nga librat kontabël të kompanisë Vera për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

	Debi	Kredi
Ndërtesat	800,000	
Impiantet dhe paisjet	375,000	
Automjetet	260,000	
Fitimet e mbajtura		510,180
Aksionet e zakonshme 50 cent		350,000
Premia		50,000
10% Dëftesat e pagueshme		50,000
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Ndërtesat		100,000
Impiantet dhe paisjet		225,000
Automjetet		142,750
Stoqet	127,500	
Blerjet	865,000	
Shitjet		1,515,800
Llogaritë e arkëtueshme	85,960	
Llogaritë e pagueshme		51,510
Kthimet nga shitja	3,780	
Kthimet e blerjeve		4,870
Zbritjet e lejuara	10,300	
Zbritjet e pranuar		15,200
Lejmi për borxhet e dyshimta		3,760

Paraja e gatshme	5,870	
Dividenta e zakonshme	3,500	
Shpenzimet e qirasë	69,000	
Shpenzimet e ndryshme	16,000	
Shpenzimet e pagave	386,800	
Shpenzimet e borxheve të këqija	10,360	
Totali	3,019,070	3,019,070

Më poshtë i gjeni informatat shtesë për vitin e cekur:

1. Stoqet më 31 Dhjetor 2016 ishin 152,350 €.
2. Në shitje është përfshirë një vlerë prej 7,500 € të cilat i janë dërguar një klienti ,por ende nuk janë marr në dorëzim. Më 10 Janar 2017 klienti ka pranuar një pjesë të mallit në vlerë 4,500€ dhe duke kthyer pjesën tjetër. Kompania Vera cakton çmimet me marzhen 50% mbi koston.
3. Në shitje është përfshirë gabimisht një vlerë 5,000€, këto ishin të ardhura nga emetimi i 5,000 aksioneve të zakonshme.
4. Një klient që kishte borxh ndaj kompanisë 2,060€ kishte falimentuar. Ky borxh duhet të shlyhet direkt.
5. Duhet të bëhet një zbritje e lejuar në para të gatshme prej 2% e të arkëtueshmeve.
6. Lejimet për borxhet e dyshimta duhet të jenë 5% e të arkëtueshmeve.
7. Qiraja vjetore është 30,000€ dhe janë llogaritur vetëm deri më 30 Shtator 2016.
8. Zhvlerësimi duhet të ndahet për pasuritë me normat e poshtëshënuara:
 - a) Ndërtesat: 2% të koston
 - b) Impiantet dhe paisjet : 20% të koston
 - c) Automjetet: 25% të Vlerës neto në libra
9. Është propozuar dividend për aksionet e zakonshme prej 1.5c për aksion.
10. Duhet të kalkulohet interesi prej 10 % në dëftesat e pagueshme, i cili ende nuk është paguar.

Kërkesa:

Përgatiteni Pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016. Bëni regjistrimet në ditar për shënimet e mësipërme dhe mbështetini të gjitha korrigjimet në të dhënat nga Bilanci vërtetues.

30 pikë

Zgjidhja e problemit 5

Kompania Vera

Pasqyra e të Ardhurave për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2006.

	€	€
	€	
Shitjet (1,515,800-7,500-5,000)	1,503,300	
Kthimet nga shitjet	<u>(3,780)</u>	
		1,499,520
KMSH:		
Stoqet më 1/1/16	127,500	
Blerjet	865,000	
Kthimet e blerjeve	<u>(4,870)</u>	
Stoqet më 31/12/16 (152,350 +5,000 shënimi më poshtë)		(157,350)
		<u>(830,280)</u>
Fitimi bruto		669,240
Zbritjet e pranuar		15,200
Të hyrat nga borxhet e dyshimta		16
Zbritjet e lejuara (10,300+1,528 LI1)		(11,828)
Qiraja (69,000+30,000*3/12)		(76,500)
Shpenzimet e ndryshme		(16,000)
Shpenzimet e pagave		(386,800)
Borxhet e këqija (10,360+2,060)		(12,420)
Zhvlerësimi:		
Ndërtesat	16,000	
Impiantet dhe paisjet		75,000
Automjetet		29,313
Interesi në Dëftesat e pagueshme		5,000
Fitimi neto		55,595

Llogaritja 1: $LL/A=85,960-7,500-2,060=76,400$

Zbritja e lejuar= $2\%*76,400=1,528$

Llogaritja 2: Lejimet në fund= $(76,400-1,528) * 0.05=3,744$

Të hyrat nga borxhet e dyshimta= Lejimet në fillim- Lejimet në fund= $3,760-3,744=16$

Korrigjimet në ditar:

1. Debi	Shitjet	7,500		
	Kredi	Llogaritë e arkëtueshme	7,500	
Debi	Stoqet në fund	(7500/1.5)	5,000	
	Kredi	KMSH	(7500/1.5)	5,000

Shënim: Shitjet 7,500 (150%)
KMSH 5,000 (100%)

2. Debi	Shitjet	5,000		
	Kredi	Aksionet e zakonshme	2,500	
	Kredi	Premia e aksioneve	2,500	
3. Debi	Shpenzimet e borxheve të këqija	2,060		
	Kredi	Llogaritë e arkëtueshme	2,060	
4. Debi	Zbritja e lejuar	1,528		
	Kredi	Llogaria e arkëtueshme	1,528	
5. Debi	Lejimet për borxhet e dyshimta	16		
	Kredi	Të hyrat nga borxhet e dyshimta	16	
6. Debi	Shpenzimet e qerasë	7,500		
	Kredi	Qeraja akruale	7,500	
7. Debi	Shpenzimet e zhvlerësimit-Ndërtesa	16,000		
	Kredi	Zhvl. i akumuluar-Ndërtesa	16,000	
Debi	Shpenzimet e zhvlerësimit-Impijante të prodhimit	75,000		
	Kredi	Zhvl. i akumuluar- Impijante të prodhimit		75,000
Debi	Shpenzimet e zhvlerësimit-Automjete	29,313	(260,000-	
		142,750)*25%		
	Kredi	Zhvl. i akumuluar-Automjete		29,313

9.----- Nuk ka regjistrim, dividenda vetëm është propozuar nuk është deklaruar

10. Debi	Shpenzimet e interesit	5,000	(10%*50,000)
	Kredi	Interesi i pagueshëm	5,000